

NDRYSHIMI FILLON



ME NE

SISTEMI MË I MIRË I QEVERISJES

RIAD (13), BURIM (13), REJAN (13), LORETA (13), DIOLENT (13), ERDONITA (13)

Demokracia dhe llojet e saj

Demokracia është një lloj i qeverisjes ku pushtetin e ka populli. Demokracia ndahet në demokraci përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë. Demokracia e drejtpërdrejtë aplikohet në shtetet e vogla ku zgjedhen përfaqësuesit aty për aty.


Ndërsa, demokracia përfaqësuese është kur populli del në procesin zgjedhor, voton dhe zgjedh përfaqësuesit e vendit. Demokracia përfaqësuese ndahet në: parlamentare dhe presidenciale.

Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare. Elementet kyçe të demokracisë janë: liria, paqja, toleranca, solidariteti, bashkëpunimi, edukimi, vetëbesimi, respekti, sinqeriteti, barazia, të drejtat etj.

Të jetuarit në një shtet demokratik është gjë e mirë, sepse çdo njeri ka të drejtë të shprehë mendimin e tij lirshëm.



Ne jemi pjesë e demokracisë




Këtu i gjeni informacionet e ndryshme për demokracinë



Ne duke bërë punime për demokracinë




Gazetarët e demokracisë



Paqe për të gjithë



Virtytet demokratike, të cilat ne duhet t'i kemi




Ndarja e pushtetit dhe institucionet përkatëse




„Të gjithë për një demokraci të mirë“



„Gazetaria qenka me të vërtetë profesion i mirë“




Llojet e zgjedhjeve në Kosovë



Tempulli i dijes



Puna jonë është shumë e rëndësishme




Mendimet e gazetarëve mbi demokracinë

SHTËPIA E POPULLIT

RINA (13), TRINGA (13), MELOS (13), LISA (13), DIANA (13), AMAR (13)

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS



Mënyra e qeverisjes së shtetit demokratik të Republikës së Kosovës

Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e popullit“, sepse përfaqëson një shtet demokratik. Kuvendi përfaqëson shtetin dhe popullin, miraton, shfuqizon dhe propozon ligje, mbikëqyr punën e qeverisë dhe zgjedhë Qeverinë dhe Presidentin.

Funksionet e Kuvendit janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni i kontrollit. Funksioni përfaqësues është se përfaqëson popullin, funksioni legjislativ, sepse miraton ligje, funksioni kontrollues, sepse kontrollon Qeverinë e cila përbëhet prej Kryeministrit, ministrave dhe zëvendësministrave. Sipas ligjit në Republikën e Kosovës 30% të ulëseve të deputetëve janë të garantuara për gratë. Deputetët zgjedhen nga votat e qytetarëve, kurse Qeveria zgjedhet nga votat e deputetëve. Ka tri forma të votimit: në mënyrë elektronike, me shkrim, dhe votim me dorë sipas mënyrës së vjetër. Në Kuvend ka komisione p.sh. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Ar-

sim, Komisioni për Shëndetësi etj. P.sh. për votim për ligjin për buxhet, së pari projektligji kalon në Komisionin për Buxhet dhe Financa, pastaj kalon në votim në seancë plenare.

Seanca plenare mund të mbahet nëse ka kuorum. Kuorumi është kur në sallë janë prezent 60+1 deputetë. Pa kuorum nuk mund të kryhet votimi. Kryesia e Kuvendit që përbëhet prej kryetarit të Kuvendit dhe nënkryetarëve, mbajnë mbledhje të hënave ku vendosin për rrjedhën e seancës plenare që mbahet të enjteve. Duke u bazuar në atë që u tha më lart, ne mendojmë se Kuvendi e posedon rëndësinë më të madhe të një shteti demokratik.

Qytetari në një shtet demokratik gëzon lirinë e shprehjes, të punës, krijimit të familjes, etj. Këto janë të drejtat të garantuara me ligjet e Kosovës, të cilat bëhen në Kuvendin tonë.

Me këtë Kuvend që kemi, pritet që Kosova në të ardhmen të zhvillohet edhe më shumë në aspektin ekonomik, arsimor dhe shëndetësor.




Gazetarët e Kuvendit



Autorët e artikullit

SISTEMI I ZGJEDHJEVE NË VENDIN TONË

UJRON (13), AULONA (13), FLORINA (14), VLERA (13), ALBIONA (13)



Llojet e zgjedhjeve

Në jetën e përditshme ndodhin shumë gjëra të cilat kanë lidhje me zgjedhjet.

Kur e dëgjojmë fjalën zgjedhje, na tingëllon si zgjedhje parlamentare dhe komunale.



Thënë më mirë, zgjedhje ku vendoset për të ardhmen e vendit.

Por në fakt zgjedhjet janë proces që ndodhin edhe në përditshmëri. Si p.sh.: në mëngjes bëjmë zgjedhjen e rrobave, zgjedhjen e ushqimit, zgjedhjen e shoqërisë, etj. Ka ndodhur që në jetën e përditshme të jemi në dilemë në mes të dy zgjedhjeve të ndryshme. Mirëpo, gjithmonë janë disa faktorë që na ndihmojnë të bëjmë zgjedhjen.

Zgjedhjet, gjithashtu janë forma më e mirë dhe demokratike për të marrë pushtetin.

Zgjedhjet bëhen përmes votave të qytetarëve. Qytetarët kanë të drejtën e votimit për vendin e tyre në momentin që ata i mbushin 18 vjet, sepse që atëherë fillon edhe pjekuria e personit.

Githashtu, për votim nuk ka të drejtë që të përzihet askush, sepse ajo është e drejta jonë.

Në Kosovë ekzistojnë dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet komunale.

Tek zgjedhjet qendrore, qytetarët i votojnë deputetët të cilët kanë mandat 4 vjeçar, ndërsa tek zgjedhjet komunale, qytetarët i votojnë kryetarët e komunave dhe asambleistët, të cilët poashtu kanë mandat 4 vjeçar.

Rëndësi tjetër shumë të madhe ka vota, sepse për një votë mund të bëhet ndryshimi, prandaj qytetarët kanë për obligim që të votojnë për të mirën e vendit. Vota e një qytetari mund ta ndryshoj gjendjen e vendit tonë.



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë